

Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishrina”

Fakulteti Juridik



STUDIMET POSTDIPLOMIKE MASTER

DREJTIMI FINANCIAR

PUNIM DIPLOME

**KONKURRENCA TATIMORE VERSUS
HARMONIZIMI I TATIMEVE, RASTI I KOSOVËS**

Mentor:

Prof. dr. Fitore Morina
Dibrani

Kandidat:

Agona

PRISHTINË, 2

ABSTRAKT

Në një mjedis të globalizuar, politika tatimore ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve. Ky studim ka për qëllim të shqyrtojë dhe të krahasojë dy koncepte kyçe në fushën e politikave tatimore: konkurrencën tatimore dhe harmonizimin e tatimeve, duke u fokusuar në rastin e Kosovës. Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, shtetet përpiqen të tërheqin investime dhe të stimulojnë zhvillimin ekonomik përmes politikave tatimore tërheqëse. Konkurrenca tatimore, që nënkupton uljen e normave tatimore për të rritur investimet dhe aktivitetet ekonomike, ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në shumë shtete, përfshirë Kosovën. Nga ana tjetër, harmonizimi i tatimeve ka për qëllim harmonizimin e normave dhe rregulloreve tatimore mes shteteve, për të krijuar një sistem më të drejtë dhe të qëndrueshëm, duke reduktuar mundësitë për shmangie tatimesh dhe duke siguruar një konkurrencë më të drejtë ndërkombëtare.

Në këtë kontekst, Kosova ka pasur sfida dhe mundësi për të zhvilluar një sistem tatimor të efektshëm që është i harmonizuar me rregullat dhe praktikatat ndërkombëtare, por gjithashtu konkurrenca në nivel rajonal dhe global. Ky studim përdor analiza të të dhënave të mbledhura nga burime të ndryshme për të vlerësuar efektet e konkurrencës tatimore dhe mundësitë e harmonizimit të tatimeve për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës. Rezultatet e këtij studimi do të ndihmojnë në formimin e politikave tatimore që mund të kontribuojnë në rritjen e mundësive ekonomike dhe stabilitetin fiskal të Kosovës.

Fjalë kyçe: konkurrenca tatimore, harmonizimi i tatimeve, politikë tatimore, zhvillimi ekonomik, Kosova.